



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 31 dhjetor 2020
Nr. ref.:RK 1681/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI18/20

Parashtrues

Fatmir Hoti

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit PML. nr. 316/2019 të
Gjykatës Supreme, të 22 nëntorit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fatmir Hoti, me vendbanim në Gjakovë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Teki Bokshi, avokat.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [PML. nr. 316/2019] të Gjykatës Supreme, të 22 nëntorit 2019 (në tekstin e mëtejme: Aktgjykimi i kontestuar), në ndërlidhje me Aktvendimin PN. nr. 794/2019 të Gjykatës së Apelit, të 23 korrikut 2019 dhe Aktvendimin PK. nr. 278/19 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 3 korrikut 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNj).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 27 janar 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 30 janar 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Safet Hoxha gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban (anëtarë).
7. Më 7 shkurt 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës, njëherit të njëjtit iu kërkuar dorëzimi i dokumenteve shtesë.
8. Më 25 shkurt 2020, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi dokumentet e kërkuara nga Gjykata.
9. Më 17 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Procedura e rregullt penale

10. Më 16 maj 2016, parashtruesi i kërkesës me Aktgjykimin PKR. nr. 23/2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, ishte shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale nga neni 270 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe është dënuar me 1 (një) vit e 6 (gjashtë) muaj burgim, duke ia llogaritur kohën e kaluar në arrest shtëpiak, prej 30 gushtit 2013 deri më 12 shtator 2013 dhe paraburgim, prej 13 shtatorit 2013 deri më 25 shtator 2013.
11. Parashtruesi i kërkesë brenda afateve ligjore ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, për shkak të shkeljeve të ligjit penal dhe procedural.
12. Më 9 shtator 2016, Gjykata e Apelit me Aktgjykimin PAKR. nr. 421/2016 kishte refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ushtruar kundër Aktgjykimit PKR. nr. 23/2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, duke e lënë në fuqi këtë të fundit. Nga kjo datë, Aktgjykimi PKR. nr. 23/2014 i Gjykatës Themelore në Gjakovë ishte bërë i formës së prerë.
13. Pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit PKR. nr. 23/2014, të Gjykatës Themelore në Gjakovë, pala e dëmtuar kishte inicuar padi civile pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë për realizimin e dëmit të shkaktuar. Sipas shkresave të lëndës, gjyqtari i caktuar në rast, kishte kërkuar përjashtimin e tij nga gjykimi, për shkak se i dëmtuari E.H. kishte lidhje familjare me sekretaren juridike që punonte me gjyqtarin e rastit. Më këtë rast, me vendimin AGJ.I.nr.165/19, të Gjykatës Themelore në Gjakovë - dega në Rahovec, gjyqtari i rastit ishte zëvendësuar dhe rasti i është caktuar gjyqtarit tjetër sipas radhës.

Kërkesa për rishikimin e procedurës penale

14. Bazuar në vendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë - Dega në Rahovec AGJ.I.nr.165/19, të 25 marsit 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për rishikim të procedurës penale, kundër Aktgjykimit të formës së prerë PKR. nr. 23/2014 të Gjykatës Themelore në Gjakovë, me pretendimin *se ka fakte të reja të cilat mundësojnë rihapjen e Aktgjykimit në fjalë, sepse "është dashur që kjo gjykatë në mënyrë identike të veprojë në çështjen penale, e cila nuk qenka dashur që të gjykohet në këtë gjykatë dhe është dashur që të delegohet në ndonjë prej gjykatave tjera"*.
15. Më 3 korrik 2019, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktvendimit PK. nr. 278/19, e hedhë poshtë kërkesën e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, ushtruar kundër Aktgjykimit të formës së prerë PKR. nr. 23/2014, me arsyetimin se kërkesa nuk kishte bazë ligjore, ngase bazuar në pretendimet e parashtruesit të kërkesës nuk rezulton të jetë zbuluar ndonjë fakt a provë e re, e cila do ta arsyetonte aprovimin e kërkesës për rishikimin e procedurës penale.

16. Parashtruesi i kërkesës, brenda afatit ligjor, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktvendimit PK. nr. 278/19 të gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale.
17. Më 23 korrik 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktvendimit PN. nr. 794/2019, refuzoi ankesën e ushtruar nga parashtruesi i kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin [PK. nr. 278/19] e Gjykatës Themelore në Gjakovë, të 3 korrikut 2019, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë: *“... ka dhënë arsye të mjaftueshme se në rastin konkret nuk janë përmbushur kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës ndaj të dënuarit Fatmir Hoti, përkundër pretendimeve të mbrojtësit se të dënuarit të paraqitura në kërkesë, pasi që nuk ka bazë ligjore për rishikimin e procedurës të përfunduar me aktgjykim të formës së prerë të parapara me nenin 423 par. 1 të KPP-së”*.
18. Parashtruesi i kërkesës, në afat ligjor, parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me pretendimin se aktvendimet e instancave më të ulëta gjyqësore, janë përfshirë në shkelje ligjore dhe kushtetuese, përkatësisht në shkelje të së drejtës në gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
19. Më 22 nëntor 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [PML. nr. 316/2019], refuzon si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, me arsyetimin se: *“... sipas vlerësimit të kësaj Gjykate faktet dhe provat në të cilat thirret mbrojtësi në kërkesë nuk paraqesin bazë ligjore për paraqitjen e këtij mjeti juridik respektivisht nuk janë fakte të reja apo prova të reja të cilat vet ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojnë pafajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale (nënparr.1.3 i nenit 423) dhe po ashtu nuk janë fakte apo prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk e ka kryer veprimin që është i përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit (nënparr.1.5 i KPP-së) për të cilat baza ligjore e ka parashtruar mbrojtësi kërkesën”*.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me vendimet e gjykatave të rregullta në veçanti me Aktgjykimin e kontestuar i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22, 31 dhe 53 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, sepse:

“Në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 316/2019 të dt. 22.11.2019, gjykata shpreh dyshimin se përse z. Fatmir Hoti nuk ka kërkuar përjashtimin e gjykatës gjatë procedurës së rregullt gjyqësore. Z. Fatmir Hoti, dhe as mbrojtja e tij nuk kanë pasur të njohur faktin se Gjykata Themelore në Gjakovë, ka arsye për të besuar në objektivitetin e saj. Ky fakt na është bërë i njohur vetëm me datë 25.05.2019, e që ky fakt le të kuptohet dhe të dyshohet drejtpërdrejtë në objektivitetin e Gjykatës, e që gjatë procedurës penale në çështjen PKR. nr. 23/14 ngase kanë ekzistuar kushtet për përjashtimin e asaj Gjykate, konsiderojmë se ky fakt është fakt i ri i cili ka ndikuar në vendimin e gjykatës, ashtu që janë plotësuar kushtet ligjore konform nenit 423 par. 1 pika 1.3 dhe 1.5. lidhur

me 419 të KPPRK-së për rishikim të Procedurës penale lëndore. Këto fakte edhe prova janë të një rëndësie dhe cilësie të atillë që vënë në dyshim Aktgjykimin e formës së prerë, përkatësisht që të mund të shkaktojnë ndryshimin e tij. Në fakt nëse aktgjykimi, rishikimi i të cilit kërkohet e ka gjykuar një gjyqtar që ka qenë dashur të jetë i përjashtuar, paraqet shkelje fundamentale dhe absolute. Aktgjykimi i tillë është në kundërshtim me nenin 52 të Kodit të procedurës penale, ngase gjykimi i tillë nuk mund të trajtohet si gjykim i drejtë dhe i paanshëm si dhe në kundërshtim me nenet 22, 31 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.”

21. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata: “I. TË DEKLAROJË kërkesën të pranueshme; II. TË KONSTATOJË, se ka pasur shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 1, të nenit 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut III. TË SHPALLË të pavlefshëm: Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë, PK. nr. 278/19 të datës 03.07.2019, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN. nr. 794/2019 të dt. 23.07.2019 dhe Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 316/2019 dt. 22.11.2019”.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

[...].”

24. Gjykata po ashtu i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

[...]

“2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

25. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shterur mjetet juridike në dispozicion në pajtim me kërkesat e nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; e ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston në Gjykatë dhe të drejtat kushtetuese që pretendon se i janë cenuar, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, si dhe e ka dorëzuar kërkesën në kohë në pajtueshmëri me nenin 49 të Ligjit.
26. Megjithatë, Gjykata gjithashtu merr parasysh edhe kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Rregullore të punës dhe për rastin konkret i referohet rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë], nënregullit (3) (b) të Rregullores së punës, që përcakton:

(3) “Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...].”

27. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 22, 31 dhe 53 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, nga arsyet e cekura tek pjesa e pretendimeve.
28. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë, bie në fushëveprimin e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6.1 të KEDNj-së, përkatësisht shkelja e pretenduar ndërlidhet me paanshmërinë objektive të gjykimit.
29. Në lidhje me këtë, Gjykata fillimisht vë në dukje se, kërkesa e parashtruesit të kërkesës për rishikimin e procedurës penale, nga gjykatat e rregullta u refuzua nga shkaku se e njëjta nuk i plotësonte kriteret procedurale të parapara me ligj, sepse parashtruesi i kërkesës nuk kishte ofruar fakte dhe prova të reja me të cilat do të vihej në pikëpyetje ligjshmëria dhe kushtetutshmëria e aktgjyqimeve në lidhje me procedurën e rregullt penale.
30. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se pajtueshmëria *ratione materiae* e një kërkesë me Kushtetutë rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. Të drejtat, në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës, duhet të mbrohen me Kushtetutë në

mënyrë që ankesa kushtetuese të jetë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën dhe, rrjedhimisht, brenda juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese (shih, Gjykata Kushtetuese, rastin KIo7/17, parashtues *Pashk Mirashi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 29 majit 2017, paragrafin 66).

31. Në vazhdim, Gjykata rikujton praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe praktikën e saj, ku thuhet se neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] i Kushtetutës dhe neni 6, paragrafi 1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] i KEDNJ-së, nuk zbatohen tek kërkesat për rishikim, apo përsëritje të procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, me parashtues *Sabri Ferati*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, me parashtues *Rrahim Hoxha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016; shih, *inter alia*, *Zawadzki kundër Polonisë*, aplikimi nr. 34158/96, i 6 korrikut 1999; *Sablon kundër Belgjikës*, kërkesa nr. 36445/97 e 10 prillit 2001 dhe *Steck-Risch dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (dec), nr. 29061/08, 11 maj 2010, *Nistler kundër Austrisë*, nr. 24912/08, GJEDNJ, Vendim i 19 nëntorit 2013; *Dichev kundër Bullgarisë*, nr. 1355/04, GJEDNJ, Aktgjykim i 27 janarit 2011).
32. Në rastin konkret, Gjykata specifikisht i referohet rastit të GJEDNJ-së *Franz Fischer kundër Austrisë*, ankesa nr. 27569/02, Vendimi i 6 majit 2003, ku u konstatua se neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet në procedurat për rishikimin e ndonjë rasti, përkatësisht kur një person dënim i të cilit është bërë i plotfuqishëm, bën kërkesë për rishikimin e rastit të tij dhe gjatë kësaj procedure nuk është “akuzuar për vepër penale”.
33. Andaj, Gjykata përsëritë qëndrimin e saj se në të gjitha rastet kur kërkesa për rishikimin e procedurës penale hedhet poshtë ose refuzohet, për shkaqe procedurale, nga të gjitha instancat e rregullta gjyqësore, neni 31 i Kushtetutës, në dritën e interpretimit të nenit 6.1 të KEDNJ-së, nuk është i zbatueshëm, pasi gjykatat nuk kanë rihapur çështjen e gjykuar dhe nuk kemi një përsëritje të procedurës ku do të vinte më pas në shprehje aplikimi i këtyre dispozitave.
34. Në këtë sfond, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtuesit të kërkesës në lidhje me refuzimin nga gjykatat e rregullta të kërkesës së tij për rishikim të procedurës penale nuk janë *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën.
35. Si përmbledhje, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtuesit të kërkesës në lidhje me kërkesën për rishikimin e procedurës penale, duhet të deklarohet gjithashtu e papranueshme, në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (3) (b) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 17 dhjetor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi